



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12 Prill 2021

Nr: 222

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR DHE PËRKTHYESVE TË AMBASADËS  
SË REPUBLIKËS SLLOVAKE, TË AMBASADËS SË REPUBLIKËS ÇEKE, TË  
AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, TË AMBASADËS  
AUSTRIAKE DHE AMBASADËS GREKE PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR  
KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021.**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediae dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Sllovaqe për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Çeke për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë kërkesën e Ambasadës së Maqedonisë së Veriut për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.



Data: 12 Prill 2021

Nr. 222

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Ambasadës së Republikës Sllovaqe, të Ambasadës së Republikës Çeke, të Ambasadës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të Ambasadës Austriake dhe Ambasadës Greke për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021.

4. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Austriake për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 6 (gjashtë) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Greke për akreditimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 8 (tetë) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 5, bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

